

# Rregullore

## Për ruajtjen e Resurseve Gjenetike të Bimëve(R.GJ.B.) në fermë

Ruajtja e R.GJ.B.në fermë realizohet për mbrojtjen e resurseve gjenetike bimore me vlera të veçanta të cilat gjenden në ruajtje të lirë në natyrë në zona dhe fermerë në të gjithë territorin e vendit. Për ruajtjen në fermë caktohen ato zona dhe fermerë ku gjenden bimë autoktone me vlera ekonomike, bimë të egra me vlera të veçanta të cilat janë në rrezik zhdukje dhe duhet të merren në ruajtje.

### Neni 1

#### Kriteret të përgjithëshme:

1. Identifikimi fermerëve që realizojnë ruajtjen në fermë të R.GJ.B autoktone.

Në këtë grup do të përfshihen fermerët:

- Që kanë në ruajtje aksesione autoktone që përfaqësojnë kultivar, popullata,klone etj të zonës.
- Që kanë në ruajtje individë të veçantë me vlera jo vetëm ekonomike, por dhe historike e kulturore.
- Preferohen fermerë që kanë në ruajtje më shumë individë për çdo aksesion.

2. Inventarizimi i resurseve gjenetike autoktone (të vendit) që ruhen në fermë.

Në këtë formë ruajtje do të përfshihen:

- Resurset gjenetike të pemëve frutore, ulli, agrume dhe hardhi.
- Resurset gjenetike të bimëve të arave.
- Resurset gjenetike të bimëve mjekësore dhe aromatike
- Resurset gjenetike të drurëve pyjorë
- Resurset gjenetike të bimëve ornamentale
- Resurset gjenetike të bimëve të egra.

3. Informacion i përgjithshëm për gjendjen e fermës.

- Niveli dhe shpërndarja e diversitetit gjenetik të mbajtur nga fermerët gjatë gjithë kohës në zonën ku shtrihet ferma.
- Mënyra e përdorur për të mbajtur këtë diversitet gjenetik në fermë.
- Faktorët që influencojnë në vendimmarrjen e fermerit për të ruajtur diversitetin në fermë.

- Kujdestari që e mban këtë diversitet në fermë (burrat, gratë, të rinjtë, pleqtë, grupe të qarta etnike)
4. Përcaktimi i specieve, formave , popullatave, varieteteve, kryqëzimeve në zonën e kërkuar.
- Lista e aksesioneve që ka ferma sipas specieve.
  - Tipi i materialit të përdorur për këto aksesione
  - Vlera agroekonomike dhe shkencore e aksesionit
  - Statusi që do të ketë për ruajtje
5. Përcaktimi i fermave ( vendit ) që do të shërbejë për ruajtje.
- Ferma të ruajë procesin e evolucionit dhe përshtatjes të bimëve në kushtet e tyre të mjedisit të njëjta me kushtet e zonës.
  - Të ruajë llojshmërinë në nivele të ndryshme – ekosistem, specie dhe brenda specieve.
  - Fermeri të jetë i integruar në sistemin kombëtar të resurseve gjenetike të bimëve.
  - Të përmirësojë nivelin e jetesës për fermerët nëpërmjet zhvillimit social dhe ekonomik.
  - Të mbajë ose rrisë interesin e fermerëve në ndërhyrjet te resurset gjenetike të bimëve.

## **Neni 2**

### **Ruajtja në fermë**

Për ruajtjen në fermë (on farm), për çdo rast do të hartohet marrëveshje midis palëve që do të miratohet nga Universiteti Bujqësor Tiranë, Qendra e Resurseve Gjenetike (Banka Gjenetike) dhe Sipërmarrësi (fermeri).

## **Neni 3**

### **Të drejtat dhe detyrat e QRGJ**

#### **A. Të drejtat**

1. Universiteti Bujqësor i Tiranës, Q.R.GJ.(B.GJ.) është përgjegjës i të gjitha aksesioneve të cilat vlerësohen për tu ruajtur në fermë.
2. Përcakton fermat dhe fermerët për tu përfshirë në sistemin kombëtar të resurseve gjenetike.
3. QRGJ kërkon nga sipërmarrësi (fermeri) të gjitha të dhënat për treguesit e aksesioneve sipas pasaportës.
4. QRGJ mban listën e aksesioneve dhe dokumentacionin e plotësuar sipas standartit të

bankës gjenetike.

5. Çdo ndërhyrje në këto aksesione do të bëhet vetëm me miratimin e QRGJ.
6. Miraton futjen për ruajtje të aksesioneve të reja.

#### **B. Detyrat**

1. QRGJ bën studimin , karakterizimin dhe vlerësimin e aksesioneve të ruajtura në fermë.
2. Harton metodikat për studimin, karakterizimin dhe vlerësimin e aksesioneve të ruajtura në fermë.
3. Siguron mbështetjen financiare për ruajtjen në fermë të aksesioneve.
4. Harton marreveshjen për ruajtjen e aksesioneve në fermë.

### **Neni 4**

#### **Të drejtat dhe detyrat e Sipërmarrësit (fermerit)**

##### **A. Të drejtat**

1. Sipërmarrësi konsiderohet pjesë e sistemit kombëtar të ruajtjes së resurseve gjenetike të bimëve për zonën ku ndodhet, pas miratimit nga Q.R.GJ..
2. Kërkon nga institucioni përgjegjës zbatimin e rregullores për futjen në ruajtje të aksesioneve të reja.
3. Kërkon plotësimin e detyrimeve kontraktore nga institucioni përgjegjës.

##### **B. Detyrat**

1. Përgjigjet për mirëmbajtjen e resurseve gjenetike të miratura
2. Merr përsipër ruajtjen e resurseve gjenetike nga dëmtimet.
3. Zbaton me përpikmëri realizimin e teknologjisë së kultivimit.
4. Plotëson të dhënat e kërkuara nga institucioni përgjegjës për çdo aksesion.
5. Fermeri nuk ka të drejt të shpërndajë material për shumëzim për këto aksesione.

Miratuar në mbledhjen e Qendrës së Resurseve Gjenetike (Banka Gjenetike) me nr. Prot....16...datë...7/11....2008.

**Përgjegjësi**

**Prof.Dr. Halit SULOVARI**